



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1607/7 prot.

Tiranë më 25.10.2023

REKOMANDIM

Nr. 37, datë 25.10.2023

PËR KONTROLLUESIN “ALBANËT I-M SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Albanët I-M SH.P.K.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 158, datë 03.10.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus të veçantë publikimin/ informimin/ njoftimin/ marketingun dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K31802019N, dhe ushtron aktivitetin si institucion arsimor privat parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “nxënës”, “punonjës”, “kujdestar ligjor”, “kandidat për punë”, “vizitorë të faqes së internetit www.albanet.edu.al”, si dhe “vizitorë të ambienteve të zyrave”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dhe të sekretarisë mësimore dokumentacionin për stafin akademik, prindër/kujdestar ligjor dhe nxënësit. Konstatohet se në Zyrën e Sekretarisë ruhen kopje të CV dhe kartës së identitetit, të punonjësve të larguar.

Nga analizimi i Rregullores së Brendshme të Kontrolluesit, si dhe të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, në cilësinë e provës materiale, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit si dhe udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

3. Kontrolluesi për secilën klasë mësimore aplikon formularin “Deklaratë” për prindërit, nëse është dakord ose jo për publikimin e fotografive të fëmijëve në rrjetet sociale të tilla si “Facebook” dhe “Instagram”. Megjithatë, rezulton se edhe në këtë formular, informimi nuk është i plotë.

Informimi nga Kontrolluesi nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit të “Politikave të Privatësisë”, në faqen zyrtare www.albanet.edu.al.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim” në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi pas marrjes në dijeni të urdhrimit të hetimit administrativ ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*kujdestari ligjor*”, “*kandidatë për punë*”;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4.1, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*Numri i telefonit*”, “*Vërtetimi vaksinimi*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”, të tilla si “*publikimi i ftove/video në rrjetet sociale*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*” të tilla si “*institucionet shtetërore ku bëhen deklaram*”;

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi nuk disponon një Rregullore “*për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*për çdo kategori subjekti të dhënash*) sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqitën në seancën dëgjimore, datë 17.10.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë shprehur qëndrimin e tyre, konkretisht:

- Lidhur me konstatimin e pikës tre të procesverbalit Kontrolluesi argumenton se, “*Ruajtja e tyre bëhet në përputhje me ‘Rregulloren për funksionimin e Insitucioneve Arsimore Parauniversitare-IAP në republikën e Shqipërisë, datë 28.01.2020, ‘Kreu XXII neni 115. Në çdo deklaratë pëlqimi të dhënë nga punonjësit, prindërit, kujdestari ligjor, është bërë me dije afati i ruajtjes së dokumenteve në përputhje me rregulloren*”.

Në lidhje me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi nga ana e Kontrolluesit nuk u arrit të dokumentohet që ka të përcaktuar afatin kohor në një akt të brendshëm (rregullore/ politikë) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Kontrolluesi rast pas rasti duhet të bëjë një vlerësim, për të gjitha proceset e përpunimit në mbështetje të ligjeve apo akteve nënligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë, dhe mbas analizimit të secilit proces përpunimi, duhet të marrë masa për përcaktimin dhe rregullimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave për secilën kategori të dhënash të grumbulluara.

- Lidhur me konstatimin e pikës katër dhe të pestë të procesverbalit, Kontrolluesi argumenton se, *“Prindi ka firmosur deklaratën e pëlqimit për publikimin e materialeve në rrjetet sociale, në të cilën sqarohet që mbledhja dhe përpunimi të dhënave bëhet në përputhje me politikën e privatësisë të publikuar në faqen zyrtare të shkollës, në datë 16.10.2023, e cila është dhënë prindërit fizikisht në fillim të shkollës. Politikat e privatësisë së bashku me deklaratën parashtrojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes dhe masat e sigurisë”*.

Në lidhje me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi nga provat e administruara si *“Deklaratë”* pëlqimi për prindin/kujdestarin ligjor për publikimin e videove, fotove në rrjetet sociale, Kontrolluesi nuk informon qartësisht mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale të *“fëmijëve”* të tyre, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, sipas parashikimeve të Ligjit.

- Gjithashtu, Kontrolluesi vendosi në dispozicion Rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, Rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*për çdo kategori subjekti të dhënash*), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
3. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryej përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 5 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
8. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative

përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 25.10.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi